

Forcimi i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil dhe Bashkëpunimi Institucional – Takim me Ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), priti në një takim zyrtar Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Michel Tarran.



Gjatë takimit, Komisionerja falënderoi Prezencën e OSBE-së për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e reformave ligjore dhe administrative në vend dhe theksoi nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale në monitorimin e shërbimit civil, zhvillimin e metodologjive bashkëkohore të mbikëqyrjes, organizimin e programeve trajnuese dhe shkëmbimin e eksperiencave me institucionet homologe në rajon dhe në shtetet anëtare të OSBE-së dhe Bashkimit Evropian.



Komisionerja njohu Ambasadorin me objektin e veprimtarisë së institucionit, si dhe me risitë e parashikuara në draftligjin “Për nëpunësin civil”, të cilat lidhen drejtpërdrejt me procesin e mbikëqyrjes së shërbimit civil.

Ajo u ndal gjithashtu në punën për ngritjen e një sistemi të kompjuterizuar gjithëpërfshirës për procesin e monitorimit, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe adresimin në kohë të problematikave, në përputhje edhe me rekomandimet e Kuvendit.

Biseda u përqendrua në prioritetet e institucionit për konsolidimin e rolit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rritjen e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht me Prezencën e OSBE-në, si dhe forcimin e bashkëpunimit të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë, në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rritjes së efektivitetit të mekanizmave të mbikëqyrjes.

Nga ana e tij, Ambasadori Tarran i uroi suksese Komisioneres në detyrën e saj dhe shprehu gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin në të gjitha çështjet e trajtuara, përfshirë ofrimin e ekspertizës në monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatave elektorale, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira për garantimin e paanshmërisë dhe profesionalizmit të administratës publike.

